



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 70 prot.

Kamëz, më 14.06 2024

V E N D I M

Nr. 70 Datë 14/06/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 103 DATË 18.12.2023 "PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2024, 2025, 2026".**
Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. 14/06/2024, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin
nr.50 dt 12/06/2024,

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Nr. 3 datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02.2022, për një ndryshim në udhëzimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- VKM nr.354 dt 05.06.2024 "Per disa ndryshime ne V.K.M 412 dt. 15.06.2022" Per perdorimin e fondit te rindertimit .."
- VKM nr.365 dt 05.06.2024 "Per disa ndryshime ne V.K.M 166 dt. 18.03.2022" Per perdorimin e fondit te rindertimit .."

V E N D O S I

Në V.K.B nr 103 datë 18.12.2023 "përmiratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2024, 2025, 2026", të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në Buxhetin e vitit 2024
2. Miratimin e Ndryshimeve të Tabelen e burimeve të financimit për vitin 2024
3. Miratimin e Buxhetit për Ndermarjen Gjellberimit Parqeve dhe Rekreacioneve Kamez, për vitin 2024 dhe ndryshimeve në Ndermarjen e Pastrimit Kamez.
4. Miratimin e ndryshimit të pikës 13 të V.K.B nr. 103 date 18.12.2023 për ndryshim të punonjëve të Aparatit të Bashkisë dhe ndërmarjeve të varësisë, sipas tabelës nr.15/2 bashkëlidhur këtij projekt vendimi .
5. Miratimin e ndryshimeve në tabelen e shpenzimeve të funksionimit në Buxhetin e vitit 2024.
6. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e Investimeve në Buxhetin e vitit 2024.
7. Miratimin e strukturës buxhetore për vitin 2024 (për ndryshimet) sipas tabelës bashkëlidhur.
8. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

